

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË**  
**Shoqëria Përmbareuese "Tirana Execution Office" (TEO) SHPK**  
**NIPT L22412014N**  
**Licencë LN-5977-12-2012**

Nr. 232/5 Prot.  
Nr. 232 Regj.

Datë 21.03.2019

**URDHËR**  
**PËR VËNIEN E SEKUESTROS**

**Drejtuar:** Qendrës Kombëtare të Biznesit, Tiranë

**Për dijëni Debitorit:** Shoqëria "Apoll Net" SHPK me Nipt L22723402J, me seli në: Lagjia Apollonia, Sheshi Fitorja, Godina pranë Foto Rustemi, Fier.

**Për dijëni Kreditorit:** Autoriteti i Mediave Audiovizive, me adresë në rruga "Papa Gjon Pali II", Nr. 15, Tiranë.

Pranë shoqërisë përmbareuese "Tirana Execution Office" (TEO) SHPK, sipas kërkesës Nr. 321 Prot., datë 17.01.2019, të kreditorit Autoriteti i Mediave Audiovizive, është regjistruar çështja përmbarimore me nr. 232 Regj, datë 17.01.2019 me palë:

**Kreditor:** Autoriteti i Mediave Audiovizive  
**Debitor:** Shoqëria "Apoll Net" SHPK  
**Objekti:** Vënie në ekzekutim të titullit ekzekutiv vendim nr. Vendimi nr. 50, datë 29.03.2016 të AMA-s për të cilin është lëshuar vendimi nr. 681, datë 27.02.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për "Lëshimin e urdhrit të ekzekutimit".

Unë përmbareuese gjyqësore private Fatjona Duka, pasi u njoha me aktet e dosjes përmbarimore:

**KONSTATOVA**

Se, kreditori Autoriteti i Mediave Audiovizive me vendimin nr. 50, datë 29.03.2016 ka vendosur heqjen e autorizimit të subjektit debitor, Shoqëria "Apoll Net" SHPK, si dhe ka bërë një përlllogaritje të detyrimeve financiare për këtë subjekt. Debitori edhe pse ka pasur dijëni për këtë vendim dhe detyrimin e tij nga kreditorit Autoritetit të Mediave Audiovizive, nuk ka paguar vullnetarisht detyrimet financiare.

Në këto kreditori Autoriteti i Mediave Audiovizive i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për titullin ekzekutiv vendim nr. 50, datë 29.03.2016, në lidhje me shlyerjen e detyrimeve në shumën 2.715.467 (dy milion e shtatëqind e pesëmbëdhjetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë.

Gjykata e Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, pasi ka marrë në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga Autoriteti i Mediave Audiovizive, me vendimin nr. 681, datë 27.02.2018, me të cilin ka vendosur:  
"- Pranimin e pjesërisht të padisë.

- Detyrimin e palës së paditur "Apoll Net" shpk t'i paguajë palës paditëse Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) detyrimet financiare në shumën prej 2.689.000 lekë.  
- Ky vendim përbën titull ekzekutiv dhe marrjen e formës së prerë është i ekzekutueshëm nga shërbimi përmbarimor.



Me anë të kërkesës drejtuar shoqërisë përmbaruese "Tirana Execution Office" (TEO) SHPK, kreditori AMA ka kërkuar vënien në ekzekutim të titullit ekzekutiv vendim Nr. 50, datë 29.03.2016 të AMA-s, për të cilin është dhënë vendimi "Urdhër ekzekutimi" nr. 681, datë 27.02.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Në kushtet kur debitori nuk ka paguar detyrimin ndaj kreditorit, në shumën 2.689.000 (dy milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë) lekë, pavarësisht dijenisë së tij për këtë detyrim, debitori do të paguajë dhe kamatëvonesat ligjore për mospagimin në afat të këtij detyrimi. Me qëllim llogaritjen e këtyre kamatëvonesave do të caktohet një ekspert dhe do t'ju komunikohet vlera e këtyre kamatëvonesave.

Në këto kushte në bazë të nenit 519, 527 të K.Pr.Civile. vendosa të filloj procedurat për ekzekutimin e detyrueshëm të titullin ekzekutiv për të cilin është lëshuar vendim nr. 681, datë 27.02.2018i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë "Për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit",

### **PËR KËTO ARSYE**

Në bazë të neneve 527 e vijues të Kodit të Procedurës Civile; Ligjit Nr. 10031, datë 11.12.2008 "Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat";

### **URDHËROJ**

1 Vënien e sekuestros në aktivet e palës debitore **Shoqëria "Apoll Net" SHPK me Nipt L22723402J.**

2. Vënien e sekuestros në kuotat ose aksionet që **Shoqëria "Apoll Net" SHPK me Nipt L22723402J** mund të zotërojë në shoqëri të tjera, në cilësinë e ortakut ose aksionarit.

3. Për veprimet ose mosveprimet tuaja, na informoni me shkresë, brenda afatit ligjor.

4. Ndaj personave që do të pengojnë zbatimin e këtij titulli ekzekutiv në kundërshtim me parashikimet e ligjit, përmbaruesi gjyqësor ka të drejtë të aplikojë sanksionet e parashikuara në nenet 598 dhe 606 të Kodit të Procedurës Civile si dhe të ndërmarrë çdo sanksion tjetër të parashikuar nga ligji.

5. Ky urdhër i njoftohet palëve të cilat në bazë të nenit 610 të K.Pr.Civile kanë të drejtën e ankimit në gjykatën kompetente brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja djeni.

**Shoqëria "Tirana Execution Office" (TEO) SHPK  
Përmbarues Gjyqësor Privat  
Fatjona Duka**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

NR. 50, DATË 29.03.2016

PËR

HEQJEN E AUTORIMIT LËSHUAR PËR SHOQËRINË "APOLLNET" SH.P.K., PËR PËRSËRITJEN E SHËRBIMIT TË PROGRAMIT AUDIOVIZIV TË TË TRETËVE MBËSHTETUR NË RRJET KABLLOR "TV APOLLNET"

Autoriteti i Mediave Audiovizive, i përbërë nga:

Gentian	Sala	Kryetar
Sami	Nezaj	Zëvendëskryetar
Gledis	Gjipali	Anëtar
Piro	Misha	Anëtar
Suela	Musta	Anëtar
Zylyftar	Bregu	Anëtar

mori në shqyrtim çështjen që i përket palëve:

Kërkues: AMA, kryesisht

Objekt : Për heqjen e autorizimit lëshuar për shoqërinë "Apollnet" sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor "Apollnet"

Baza Ligjore: Neni 19, pika 16 dhe neni 69, pika 3 e ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë",

VËREN SE:

KKRT (sot AMA) me Vendimin Nr. 172 datë 28.12.2012, ka licencuar Shoqërinë "Apoll Net" sh.p.k., për të ushtruar veprimtari televizive private kabllore si "TV Apollnet" për të mbuluar me sinjal qytetin Fier. AMA, në respektim të nenit 138, pika 4 të ligjit 97/2013, ka marrë Vendimin Nr. 23, datë 27.12.2013, ka zëvendësuar licencën e shoqërisë "Apoll Net" sh.p.k., të licencuar për të ushtruar veprimtari televizive private kabllore si "TV Apollnet", me autorizim për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor.

Nga verifikimet e kryera shoqëria "Apoll net" sh.p.k. autorizuar për ripërsëritjen e programeve të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor "Apollnet", është debitore ndaj AMA-s në masën 2,458,000 (dy milion e katërqind e pesëdhjetë e tetë mijë) lekë, si rezultat i mosshlyerjes së detyrimeve financiare, detyrim licence, për vitet 2013 – 2015 dhe në masën 399,000 (treqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë) lekë detyrim për kamatëvonesë, për vitet 2014 – 2015).



Niveli i shërbimit të mediave audiovizive në Republikën e Shqipërisë  
AMA ka marrë të heqë licencën dhe/ose autorizimin  
3. Nuk paguan detyrimet financiare të licencës për një vit.

Me shkresën nr. 856 prot. datë 11.03.2016 AMA ka njoftuar subjektin për fillimin e procedurës administrative të heqjes së autorizimit lëshuar për shoqërinë "Apoll net" sh.p.k. duke i kërkuar edhe një herë shlyerjen e detyrimeve përkatëse për pagesë vjetore për autorizim për vitet 2010 - 2013 dhe duke i lënë si afat përfundimtar datën 18.03.2016.

Nga ana e subjektit nuk u mor asnjë masë për shlyerjen e detyrimit dhe AMA, me shkresën nr. 940 prot., datë 23.03.2016 ka njoftuar subjektin se AMA do të merrte në shqyrtim çështjen e vlefshmërisë së autorizimit në mbledhjen e datës 29.03.2016, ora 13.30, duke e ftuar që të merrte pjesë dhe të jepte shpjegimet e veta. Pavarësisht këtij njoftimi, subjekti nuk ktheu asnjë përgjigje dhe nuk u paraqit në datën dhe orën e caktuar.

Për sa më sipër, Autoriteti i Mediave Audiovizive, në mbështetje të nenit 19 pika 16 dhe neni 69, pika 3 të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë",

#### VENDOSI:

1. Heqjen e autorizimit lëshuar për shoqërinë "Apoll net" sh.p.k., për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor "TV Apollnet" për shkak të mosshlyerjes së detyrimeve financiare për më shumë se një vit.
2. Subjekti duhet të ndërpresë transmetimin menjëherë, me marrjen e këtij vendimi.
3. Ngarkohet administrata e AMA-s për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
4. Kundër këtij ankimi mund të bëhet ankim në gjykatë, sipas ligjit

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar:

Gentian

SALA

Zëvendëskryetar:

Sami

NEZAJ

Anëtarë:

Gledis

GJIPALI

Piro

MISHA


Suela

MUSTA

Zylyftar

BREGU





REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE  
TIRANE

Nr.Rregj.Them. 4773/293(31138-05460-80)

Data e regjistrimit 14.09.2017

Nr.Vendimi 681

Data e vendimit 27.02.2018

**VENDIM**  
**"NE EMER TE REPUBLIKES"**

Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Tirane me trup gjykues te perbere nga:

**GJYQTARE : SEMIRAMIS HOXHOLLI**

asistuar nga sekretare gjyqesore **Anisa Zoto**, sot me datë 27.02.2018 mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore me dyer te hapura çeshtjen me nr. 4773/293(31138-05460-80) qe i perket:

**PADITËS:** Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), me adrese Rr."Papa Gjon Pali II", Tirane, perfaqesuar nga znj.Fjoralba Murati sipas autorizimit nr.3107/1 preot. date 05.10.2017.

**I PADITUR:** Shoqëria "Apoll Net" sh.p.k., me Nr. NIUS L22723402J, me adresë:Sheshi "Fitorja", Godina pranë Foto "Rustemi"-t, Lagjja Apollon, Fier, me administrator z. Redon Laze (Gjykuar ne mungese, me shpallje/afishim publik).

Me njoftimin e Avokatures se Shtetit, Zyra Vendore Tirane (Ne mungese).

**OBJEKTI:** Detyrimin e palës së paditur për të paguar detyrimet financiare kundrejt AMA-s në shumën prej 3,529,000 (tre milion e pesëqind e njëzet e nëntë mijë) lekë.

Shpenzimet gjyqësore palës së paditur

**BAZA LIGJORE:** Nenet 419 dhe 420 të ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; Nenet 154 e vijues të Kodit të Procedurës Civile; Ligji Nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, nenet 19, 23, 24,25 dhe 26; Vendimi nr. 5, datë 22.05.2013 "Mbi miratimin e pagesave për autorizim", i ndryshuar; Ligji Nr. 49/2012 .



*Ne perfundim te shqyrtimit gjyqesor te kesaj çeshtjeje, Gjykata pasi shqyrtoi dosjen ne terri dhe analizoi provat e paraqitura nga palet dhe te administruara gjate gjykimit;*

## VEREN

### *i. Rrethanat e faktit*

Pala paditese Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) i eshte drejtuar Gjykates me kerkesepadine me objektin dhe bazen ligjore te sipercituar .

Pala paditëse Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) është person juridik publik, i pavarur, me seli në Tiranë, me cilësinë e autoritetit rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë, që vepron në bazë e për zbatimin e dispozitave të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

Pala e paditur, shoqëria "Apoll Net" sh.p.k., është autorizuar nga KKRT (sot AMA) me vendimin nr. 172, datë 28.12.2012, për të ushtruar veprimtari televizive private kabllore si "TV Kabllor Apollnet", për të mbuluar me sinjal qytetin Fier, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence. AMA me vendimin nr. 23, datë 27.12.2013 ka zëvendësuar licencën me autorizim për subjektin "TV Kabllor Apollnet".

Palës së paditur shoqëria "Apoll Net" sh.p.k., bazuar në legjislacionin në fuqi, i ka lindur detyrimi financiar për pagesë vjetore për autorizim.Pala e paditëse AMA ka njoftuar palën e paditur për lindjen dhe shlyerjen e detyrimeve financiare, konkretisht me shkresat dhe faturat përkatëse ku janë përcaktuar detyrimet financiare konkrete të subjektit, si dhe detyrimet e prapambetura: nr. 578/3 prot. datë 05.03.2013 (fatura bashkangjitur nr. 182 datë 01.03.2013); nr. 344 prot., datë 06.02.2014 (fatura bashkangjitur nr. 51 datë 03.02.2014); nr. 80/5 prot., datë 16.01.2015 (fatura bashkangjitur nr.182 datë 14.01.2015); nr. 694 prot., datë 23.04.2015 , nr. 1198 prot., datë 23.06.2015 dhe nr. 152 prot., datë 15.01.2016 (fatura bashkangjitur nr.86 datë 14.01.2016).

Rezulton se pala e paditur, nuk ka shlyer detyrimet financiare ndaj palës paditëse pavarësisht kërkesave shkresore të përsëritura. Pala e paditur, nuk ka shlyer detyrimet financiare të lindura për shkak të ligjit, për periudhën 2013, 2014, 2015 dhe 2016.

Në këto kushte, pala paditëse me shkresën nr. 1198, datë 23.06.2015, ka njoftuar palën e paditur për fillimin dhe vazhdimin e procedurave të heqjes së autorizimit.

Me vendimin nr. 50, datë 29.03.2016, vendosi heqjen e autorizimit të shoqërisë "Apoll Net"



në rrjet kabllor "TV Apollnet". Ky vendim është marre ne perputhje me nenin 69 te ligjit nr.97/2013 i cili percakton se: "AMA ka te drejte te heqe licencen dhe/ose autorizimin kur: nuk paguan detyrimet financiare per nje vit.." Pavaresisht ketij vendimi dhe pavaresisht se i është hequr tashme autorizimi, Gjykata vlereson se pala e paditur shoqeria "Apoll Net" shpk vazhdon te jete debitore ndaj pales paditese AMA per vitet 2013, 2014 dhe 2015.

Ne cmim te gjykates ne detyrimet financiare te pales se paditur nuk do te duhej te perfshihej detyrimi per vitin 2016 pasi per kete vit kalendarik ajo presupozohet te mos kete ushtruar asnje veprimtari per shkak te heqjes se autorizimit nga AMA. Ajo nuk ka pasur te drejta ne kete periudhe, e nuk ka gjeneruar te ardhura e fitime, e per pasoje nuk do te duhej as te ngarkohej me detyrime. Periudha per vitin 2016 eshte nje periudhe e pambuluar me transmetim. Kesisoj, Gjykata vlereson se masa prej 3,529,000 leke nuk eshte vlere qe pala e paditur i detyrohet pales paditese, pasi kesaj vlere i duhet hequr pagesa prej 840.000 leke, vlere e cila perfaqeson pagesen vjetore per autorizim per vitin 2016. Si perfundim, pala e paditur i detyrohet paditesit AMA nje detyrim financiar prej 2.689.000 leke.

*Se treti*, duke qene se pretendimet e padise rezultuan te pranuar ne masen e  $\frac{3}{4}$  pjese te padise, Gjykata vlereson se i njejti raport do duhej te ruhej edhe sa i takon detyrimin te pales se paditur per te paguar shpenzimet gjyqesore.

### PËR KËTO ARSYE:

Gjykata, bazuar në nenet 126, 306 dhe 309 të Kodit të Procedurës Civile dhe neneve 40-42 të ligjit nr.49/2012

### VENDOSI:

1. Pranimin pjeserisht te padisë.
2. Detyrimin e pales se paditur "Apoll Net" shpk t'i paguajë palës paditëse Autoritetit te Mediave Audiovizive (AMA) detyrimet financiare ne shumën prej 2.689.000 leke.
3. Rrezimin per pjesen tjetere te kerkimeve ne kerkesepadi.
4. Shpenzimet gjyqesore i ngarkohen palës së paditur ne masen prej  $\frac{3}{4}$  pjese.
5. Ky vendim perben titull ekzekutiv dhe me marrjen forme te prere eshte i ekzekutueshem nga sherbimi permabrimor gjyqesor.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 15 ditëve në Gjykatën Administrative te Apelit Tiranë, duke filluar ky afat nga e nesërmyja e shpalljes së tij për palën paditese AMA prezent. Për palën e paditur në mungesë ky afat fillon nga dita e njoftimit të vendimit.
7. Vendimi t'i komunikohet me ane te shpalljes publike pales se paditur "Apoll Net" shpk si dhe t'i njoftohet nje kopje edhe Avokatures se Shtetit, Zyres Vendore Tirane-e.



cila e la gjykimin ne mungese.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 27.02.2018!

~~SEKRETARE  
ANISA ZOTO~~



Shpenzimet gjyqësore:

Taksa mbi aktet: 35.290 lekë


Shpenzime Njoftimi 1320 lekë

22/05/2018  
20/08/2018

~~SEKRETARE  
ANISA ZOTO~~







**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË**  
**Shoqëria Përmbareuese "Tirana Execution Office" (TEO) SHPK**  
**NIPT L22412014N**  
**Licencë LN-5977-12-2012**

Nr. 234/5 Prot.  
Nr. 234 Regj.

Datë 21.03.2019

**URDHËR**  
**PËR VËNIEN E SEKUESTROS**

**Drejtuar:** Qendrës Kombëtare të Biznesit, Tiranë

**Për dijëni Debitorit:** Shoqëria "Apoll Net" SHPK me Nipt L22723402J, me seli në: Lagjja Apollonia, Sheshi Fitorja, Godina pranë Foto Rustemi, Fier.

**Për dijëni Kreditorit:** Autoriteti i Mediave Audiovizive, me adresë në rruga "Papa Gjon Pali II", Nr. 15, Tiranë.

Pranë shoqërisë përmbareuese "Tirana Execution Office" (TEO) SHPK, sipas kërkesës Nr. 489 Prot., datë 25.01.2019, të kreditorit Autoriteti i Mediave Audiovizive, është regjistruar çështja përmbareuese me nr. 234 Regj, datë 28.01.2019 me palë:

**Kreditor:** Autoriteti i Mediave Audiovizive  
**Debitor:** Shoqëria "Apoll Net" SHPK  
**Objekti:** Vënien në ekzekutim të titullit ekzekutiv vendim nr. 20, datë 26.06.2015 i AMA-s, për të cilin është dhënë vendimi nr. Regj. Them 1310, datë 12.10.2015, "Për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit" i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Unë përmbareuese gjyqësore private Fatjona Duka, pasi u njoha me aktet e dosjes përmbareuese.

**KONSTATOVA**

Se, kreditori Autoriteti i Mediave Audiovizive me vendimin nr. 20, datë 26.06.2015 ka vendosur:  
"1. Të ndëshkojë me sanksion gjobë në masën 1.000.000 (një milion) lekë z. Artur Rustemi për subjektin kabllor "TV Apollnet".  
2. Gjoha paguhet nga kundërvajtësi brenda 10 ditëve.....Pas kalimit të këtij afati, për çdo ditë vonesë, paguhet kamatë 2% deri në një muaj".

Debitori Shoqëria "Apoll Net" SHPK me Nipt L22723402J nuk ka paguar gjobën e vendosur nga kreditori Autoriteti i Mediave Audiovizive. Në këto kushte kreditori i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për titullin ekzekutiv vendim dënim me gjobë nr. 20, datë 26.06.2015 i AMA-s.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka dhënë vendimin nr. Regj. Them 1310, datë 12.10.2015, me të cilin ka vendosur:

- Pranimin e kërkesës.  
- Lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për titullin ekzekutiv fletë gjobë Nr. 20, datë 26.06.2015 të grupit të Inspektimit të AMA-s".

Me anë të kërkesës drejtuar shoqërisë përmbareuese "Tirana Execution Office" (TEO) SHPK, kreditori AMA ka kërkuar vënien në ekzekutim të titullit ekzekutiv vendim me gjobë në shumën 1.000.000 (një milion) lekë si dhe pagesën e kamatëve vonesat ligjore lidhur me gjobën e papaguar.

Në bazë të nenit 30, pika 3, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative", i cili parashikon se: "...për çdo ditë vonesë paguhet kamatë 2 përqind në muaj të masës së gjobës..."; nenit 24, pika 1, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative", i cili parashikon se: "Vendimi për kundërvajtjen administrative bëhet titull ekzekutiv në momentin e



*nxjerrjes së vendimit përfundimtar nga organi administrativ që ka kompetencën për shqyrtimin përfundimtar të kundërvajtjes në rrugë administrative”;*

si dhe nenit 30, pika 1, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” i cili parashikon se:

*“Gjoha dhe shumat, që duhet të paguhen sipas vendimit për kundërvajtjen administrative, të nxjerrë në përputhje me dispozitat e këtij ligji, paguhen nga kundërvajtësi brenda 10 ditëve, nga data kur: a) është njoftuar kundërvajtësi për vendimin e dënimit me gjobë, që përbën titull ekzekutiv...”*

përlllogaritja e kamatave do të fillojë të llogaritet nga data 10.07.2015. Vlera e kamatave për shumën e gjobës 1.000.000 (një milion) lekë, përlllogaritet në masën 20.000 (njëzet mijë) lekë në muaj. Për muajt me 31 ditë, vlera ditore e kamatës është 645 (gjashtëqind e dyzet e pesë) lekë, ndërsa për muajt me 30 ditë vlera ditore e kamatës është 667 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë.

Nga data 10.07.2015 dhe deri ditën e nxjerrjes së këtij lajmërimi për ekzekutim vullnetar (28.01.2019) debitori detyrohet të paguajë kamatë në shumën 851.605 (tetëqind e pesëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e pesë) lekë. Debitori do të detyrohet gjithashtu të paguajë tarifë përmbartimore dhe për vlerën totale të kamatave që do të paguajë në favor të kreditorit. Vlera e kësaj tarife do të përlllogaritet në total për të gjithë kamatat që do të paguhen në favor të kreditorit AMA.

Në kushtet kur debitori nuk ka paguar detyrimin ndaj kreditorit, në shumën 1.000.000 (një milion) lekë, pavarësisht dijenisë së tij për këtë detyrim, debitori do të paguajë dhe kamatëvonesat ligjore për mospagimin në afat të këtij detyrimi. Me qëllim llogaritjen e këtyre kamatëvonesave do të caktohet një ekspert dhe do t’ju komunikohet vlera e këtyre kamatëvonesave.

Në këto kushte në bazë të nenit 519, 527 të K.Pr.Civile. vendosa të filloj procedurat për ekzekutimin e detyrueshëm të titullin ekzekutiv për të cilin është lëshuar vendim nr. Regj. Them 1310, datë 12.10.2015 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë “Për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit”;

### **PËR KËTO ARSYE**

Në bazë të neneve 527, 593 e vijues të Kodit të Procedurës Civile; Ligjit Nr. 10031, datë 11.12.2008 “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat”; Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2014 të Bankës së Shqipërisë “Për ekzekutimin e detyrimeve mbi shumat e llogarive në bankë”;

### **PËR KËTO ARSYE**

Në bazë të neneve 527 e vijues të Kodit të Procedurës Civile; Ligjit Nr. 10031, datë 11.12.2008 “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat” ;

### **URDHËROJ**

1 Vënien e sekuestros në aktivet e palës debitore **Shoqëria " Apoll Net" SHPK me Nipt L22723402J.**

2. Vënien e sekuestros në kuotat ose aksionet që **Shoqëria " Apoll Net" SHPK me Nipt L22723402J** mund të zotërojë në shoqëri të tjera, në cilësinë e ortakut ose aksionarit.

3. Për veprimet ose mosveprimet tuaja, na informoni me shkresë, brenda afatit ligjor.


4. Ndaj personave që do të pengojnë zbatimin e këtij titulli ekzekutiv në kundërshtim me parashikimet e ligjit, përmbartuesi gjyqësor ka të drejtë të aplikojë sanksionet e parashikuara në nenet 598 dhe 606 të Kodit të Procedurës Civile si dhe të ndërmarrë çdo sanksion tjetër të parashikuar nga ligji.

5. Ky urdhër i njoftohet palëve të cilat në bazë të nenit 610 të K.Pr.Civile kanë të drejtën e ankimit në gjykatën kompetente brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja dijeni.

**Shoqëria “Tirana Execution Office” (TEO) SHPK**



**Përmbartes Gjyqësor Privat**  
**Fatjona Duka**



*[Handwritten signature in blue ink]*

OR 28



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË  
TIRANË**

**Nr. Regj. Them.1310 (31100 – 06093 – 80)**

**V E N D I M**  
**“NE EMER TE REPUBLIKES”**

Gjykata Administrative e Shkalles se Pare, Tirane, e perbere nga:

**Gentian Medja – Gjyqtar**

Asistuar nga sekretare seance Orgesa Mucaj, me date 12/10/2015, mori ne shqyrtim ne seance pergatitore me dyer te hapura ceshtjen me nr.regj.them. 1310 (31100 – 06093 – 80), dt.02.10.2015, qe I perket:

**KERKUES:**                    **Autoriteti I Mediave Audiovizive.**

**OBJEKTI:**                    Leshimi i Urdherit te ekzekutimit per sanksionin me gjobe nr.20, dt.26.06.2015 te Grupit te Inspektimit te AMA-s, te vendosur ndaj subjektit person fizik Artur Rustemi, per subjektin kabllor “TV Apollonet”.

**BAZA LIGJORE:**            Nenet 510, 511 e vijues te K.Pr.Civile. Ligji nr.49/2012.

Gjykata pasi shqyrtoi ne teresi kete kerkese

**VEREN se**

Autoriteti I Mediave Audiovizive i eshte drejtuar Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Tirane, me kerkese per leshimin e urdherit te ekzekutimit per sanksionin me gjobe nr.20, dt.26.06.2015 te Grupit te Inspektimit te AMA-s, te vendosur ndaj subjektit person fizik Artur Rustemi, per subjektin kabllor “TV Apollonet”.

Nga shqyrtimi gjyqesor rezulton se me gjoben nr.20, dt.26.06.2015, inspektoret e pales se paditur kane vendosur per te denuar me gjobe personin fizik Artur Rustemi, per subjektin kabllor “TV Apollonet”, per kundervajtje te parashikuar ne nenin 133 pika 10 te ligjit nr.97/2013.

Në zbatim të nenit 133/13 te te ligjit nr.97/2013 dhe nenit 24 të ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, gjobat e vendosura nga pala kerkuese përbëjnë titull ekzekutiv.

Në këto kushte, meqenese akti administrativ përbën titull ekzekutiv, gjykata cmon se duhet te leshohet udheri i ekzekutimi per flete gjoben nr.20, dt.26.06.2015 te Grupit te Inspektimit te AMA-s.



**PER KETO ARSYE**

Gjykata, bazuar ne nenin 511 te K.Pr.Civile

**VENDOSI**


- Pranimin e kerkeses.
- Leshimin e urdherit te ekzekutimit per titullin ekzekutiv, flete gjobe nr.20, dt.26.06.2015 te Grupit te Inspektimit te AMA-s.
- Urdherohen Zyrat e Permbarimit per ekzekutimin e ketij vendimi.
- Shpenzimet gjyqesore I ngarkohen kerkuesit.
- Nje kopje e ketij vendimi ti njoftohet Autoritetit te Mediave Audiovizive.

Tirane, me 12.10.2015.

**Sekretare  
Orgesa Mucaj**



**Gjyqtar  
Gentian Medja**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE  
Drejtoria Juridike dhe Licencave

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", Tiranë Tel. +355 4 2233370, Fax. +355 4 2226287, www.ama.gov.al

Nr. 20 Prot.

Tiranë, më 26.06.2015

GJOBË

Grupi i inspektorëve të Autoritetit të Mediave Audiovizive, në zbatim të urdhrimit nr. 154, datë 06.05.2015 të Kryetarit të AMA-s "Për inspektimin e veprimtarisë së subjekteve kablllore në rrethin e Vlorës e Fierit, inventarizimin dhe sekuestrimin e pajisjeve të përdorura për ushtrimin e veprimtarive të palicencuara", në datë 07.05.2015 ka kryer kontrollin e veprimtarisë programore të subjektit kabllor "TV Apollnet" sa i përket respektimit të të drejtave të transmetimit.

Pas verifikimit të procesverbalit të kontrollit, bazuar në nenin 32, pika 6 të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", nenit 46, 83 e në vijim të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe nenit 4 - 11 të rregullores "Mbi procedurat e inspektimit/monitorimit të veprimtarisë së ofruesve të shërbimit mediatic audio dhe/ose audioviziv", me shkresën nr. 1003 prot., datë 27.05.2015, ka vënë në dijeni subjektin kabllor "TV Apollnet" për fillimin e hetimit administrativ, duke i caktuar si afat datën 11.05.2015, për depozitimin e dokumentacionit që vërteton të drejtat e transmetimit për programet, për të cilat AMA nuk dispononte asnjë kontratë/marrëveshje me mbajtësit e të drejtave të tyre, si më poshtë:

- TV Top Channel; TV Klan HD; TV RTSH HD; TV RTSH Sport; TV BBC World News; TV KCN 3; TV RTK 1.

Brenda afatit të parashikuar në hetimin administrativ (datë 11.06.2015), subjekti kabllor "TV Apollnet", me shkresën nr. 1003/1 prot., datë 18.06.2015 ka kthyer përgjigje lidhur me fillimin e hetimit administrativ, duke kërkuar ndërprerjen e tij për arsyt e mëposhtme:

1. Subjekti pretendon se për kanalet "TV BBC World News", "TV KCN 3", "TV RTK 1" gëzon të drejtën e ritransmetimit në bazë të kontratës së lidhur me platformën numerike "Tring TV". Sqarohet se këto kanale nuk përfshihen në listën e programeve që i janë kaluar subjektit nga platforma në fjalë.
2. Sipas subjektit, ritransmetimi i programeve "RTSH", "TV Klan", "TV Top Channel" bëhet në bazë të Vendimit të AMA-s nr. 4, datë 26.03.2014 "Për vendosjen e detyrimit



detyrimin të mbartjes të programeve kombëtare nga rrjetet e komunikimeve elektronike kablore të subjekteve të autorizuar për ripërcëitjen e programeve audio dhe audiovizive në këto rrjete", në zona që nuk mbulohej me sinjal nga ofruesit e shërbimit të programit kombëtar audioviziv.

Duke pasur parasysh se zona e licencimit të subjektit kabllor "TV Apollnet" mbulohet me sinjalin e televizioneve në fjalë, subjekti juaj ka detyrimin të depozitohet në AMA dokumentacionin për kalimin e të drejtave të transmetimit për këto programe.

*Subjekti i mësipërm ka transmetuar programe për të cilat nuk ka nënshkruar kontrata/marrëveshje me mbajtësit e të drejtave të këtyre programeve, akt ky që mbështetur në nenin 133, pika 7 të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" përbën kundërvajtje administrative dhe ndeshkohet me gjobe*

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 133, pika 10 të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" dhe nenit 10 të rregullores "Mbi procedurat e inspektimit/monitorimit të veprimtarisë së ofruesve të shërbimit mediatic audio dhe/se audioviziv", grupi i inspektorëve të AMA-s.

#### V E N D O S I:

1. Të ndëshkohet me sanksion gjobë në masën 1 000 000 (një milion) lekë, z. Artur Rustemi, për subjektin kabllor "TV Apollnet".
2. Gjoha paguhet nga kundërvajtësi brenda 10 ditëve në adresën:  
Banka Credins, AMA, Tiranë; Nr. Llog. 445385.  
Pas kalimit të këtij afati, për çdo ditë vonesë, paguhet kamatë 2% deri në një muaj.
3. Subjekti i mësipërm të ndërpresë menjëherë transmetimin e programeve pa të drejta.
4. Kundër kësaj gjobe mund të bëhet ankim në AMA brenda 30 ditëve nga data e marrjes dijeni.

#### Grupi i Inspektorëve

Saimir Hajdari

Enkelejd Lamaj

Shkëlqim Bylyku

